



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:002158

Datë: 09.03.2021

Numri i dokumentit: 01577991

**PKR.nr.13/2021**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti për krime të rënda, si gjykatë penale e shkallës parë**, përmes kryetarit të trupit gjykues Aziz Shaqiri, me sekretaren juridike Florentina Ademi, në lëndën penale kundër të pandehurit N. S. nga ..., për shkak të veprës penale Falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 216 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( në tekstin e mëtutjeshëm KPRK-s ), të cilin sipas autorizimit e mbron av. ..., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr. 168/2020, të datës 18.01.2021, të cilën e përfaqësoj prokurori i shtetit Arben Ismajli, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik më datë 25 shkurt të vitit 2021 e në prani të përkthyeses gjyqësore Naile Keqmezi, nxori dhe në prani të prokurorit të shtetit si dhe të të pandehurit, në të njëjtën ditë, publikisht shpalli këtë,

### **A K T G J Y K I M**

**I pandehuri N. S.**, nga i ati ..., e ëma P., e lindur S., i lindur më ..., në ..., tani me vendbanim në ..., posedues i lejes së njoftimit me numër personal..., serb, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje të mesme ekonomike, i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj të njejtit, i është tërhiqur vërejtja se është i detyruar që ta lajmëroj gjykatën për çdo ndërrim eventual të vendbanimit përkatësisht të vendqëndrimit të tij nën kërcënim të pasojave ligjore,

### **Ë s h t ë f a j t o r**

**sepse** me datën 11.06.2017, në fshatin ..., Komuna e Klllokotit, në shkollën fillore "...", i pandehuri në cilësinë e kryesuesit të Këshillit të Vendvotimit në Qendrën e votimit ..., vendvotimi me nr...., duke e shfrytëzuar pozitën e tij zyrtare apo autoritetin zyrtar në lidhje me zgjedhjet ka shtuar dhe hequr votat në atë mënyrë që pas rinumërimit në Qendrën e numërimit të rezultateve është bërë krahasimi i të dhënave ku është identifikuar ndryshimi i votave, ashtu që gjatë numërimit të votave të kandidatëve brenda subjektit politik, ka hequr votat e disa

kandidatëve dhe i ka shtuar të disa kandidatëve të tjerë duke i regjistruar në mënyrë jo të saktë gjithsej 211 vota, ku prej tyre 109 vota të shtuara dhe 102 vota të hequra,

-me çka ka kryer veprën penale falsifikimi i rezultateve të votimit nga neni 216 paragrafi 2 të KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të cituara si dhe nenit 4, 7, 21, nenit 41, 45, 49, 50, 51, 73 – 75 paragrafi 1.3 të KPRK-s si dhe nenit 365 lidhur me 248 të Kodit të Procedurës Penale ( në tekstin e mëtutjeshëm KPP-s ), të pandehurit në fjalë, i shqipton

## DËNIM ME KUSHT

**ashtuqë i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej një ( 1 ) viti, duke urdhëruar në të njëjtën kohë që ky dënim mos të ekzekutohet nëse i njëjti gjatë kohës së verifikimit prej dy ( 2 ) viteve, duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale, nën kërcënim të revokimit të tij në kuptim të nenit 53 ose 54 të KPRK-s.**

**DETYROHET** i pandehuri në fjalë që kësaj gjykate t'ia paguaj shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor në shumën prej **tridhjetë ( 30 ) Euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave shumën prej pesëdhjetë (50) Euro**, të gjitha në afat prej **tridhjetë ( 30 )** ditëve, nga dita pasuese e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm,

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore – DKR në Gjilan kundër të pandehurit në fjalë ka paraqitur aktakuzën lëndore, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale sipas përshkrimit faktik dhe cilësimit juridik si në dispozitivin e akti akuzues.

Kryetari i trupit gjykues sipas radhës ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, duke i ftuar palët sipas aktit akuzues lëndor.

Gjatë seancës së shqyrtimit fillestar i pandehuri pasiqë ishte i kombësisë serbe dhe nuk e zotëronte gjuhën shqipe, në kuptim të nenit 14 të KPP-s është angazhuar për përkthim nga gjuha shqipe në atë serbe dhe anasjelltas përkthyesja gjyqësore Naele Keqmezi, edhe atë gjer në përfundim të seancës gjyqësore fillestare, e pastaj në kuptim të nenit 246 të KPP-s kryetari i trupit gjykues e ka njoftuar të pandehurin me të drejtat e tij, ndër të tjera edhe për atë se me vet faktin që nuk kemi të bëjmë me mbrojtje të detyrueshme profesionale si i pandehur mund të kërkon që të mbroheni me mbrojtës profesional e këtë e ka bërë i pandehuri duke angazhuar mbrojtës profesional sipas autorizimit .. avokat nga Ranillugu i cili edhe ishte i pranishëm në gjykatore.

Pastaj i pandehuri u njoftua për favoret edhe për pasojat e pranimit të fajësisë, e pas kësaj i pandehuri ka deklaruar me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë shprehimisht ta pranon fajësinë

gjë që edhe e ka pranuar fajësinë shprehimisht për veprën penale sipas përshkrimit faktik dhe kualifikimit juridik si në aktakuzën lëndore.

Mbrojtësi i të pandehurit dhe prokurori i shtetit nuk e kanë kundërshtuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me arsyetim se në shkresa të lëndës ka prova të mjaftueshme për mbështetjen e kësaj akuze.

Kryetari i trupit gjykues pasi që ka vërtetuar se janë plotësuar kushtet ligjore në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPP-s dhe ka komunikuar aktvendimin procedural me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit në fjalë për veprën penale lëndore, e këtë nuk e kanë kundërshtuar palët.

Pastaj gjykata ka vazhduar me seancën e shqyrtimit fillestar për t'u deklaruar palët rreth rrethanave lehtësuese dhe rënduese, duke u përcaktuar të njëjtat edhe atë si në vijim:

Prokurori i shtetit ka deklaruar se ka prova për mbështetjen e akuzës lëndore, mirëpo gjykatës i ka propozuar që me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, me theks të veçantë se kemi të bëjmë me person i cili nuk ka të kaluar kriminale dhe nuk evidentohet për ndonjë vepër tjetër penale për të cilën zhvillohet ndonjë hetim, ka theksuar edhe faktin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit në fjalë.

Mbrojtësi i autorizuar i të pandehurit ka deklaruar se i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë andaj edhe gjykatës i ka propozuar që me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit t'i ketë parasysh rrethanat lehtësuese edhe atë pendimin e sinqert, se më parë nuk ka qenë i gjyhuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale kundër ti, se ka gjendje të dobët ekonomike, se është m,bajtës i vetëm i familjes, baba i i fëmijëve të mitur dhe në mungesë të rrethanave rënduese gjykatës i ka propozuar që të pandehurit t'i shqiptoj një dënim të putë sipas ligjit e me të cilin do të arrihet qëllimi i plotë i dënimit.

I pandehuri ka deklaruar se e mbështet në tërësi deklaratën e mbrojtësit të tij dhe nga gjykata kërkon që t'ia shqipton një dënim më të butë pasi që siç deklaroi mbrojtësi i tij është i gjendjes së varfër ekonomike dhe të ardhurat personale i ka mjaftë të ulta e në anën tjetër bashkëshorten e ka të papunësuar dhe se të ardhurat nga bujqësia i ka mjaftë të ulta.

Kryetari i trupit gjykues pasi që ka vlerësuar se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 248 paragrafi 1. të KPP-s, ka vërtetuar se ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale nga neni 216 paragrafi 2 të KPRK-s, andaj edhe menjëherë ka kaluar në shqiptimin e dënimit duke i vlerësuar edhe rrethanat lehtësuese të lartcekura.

Sa i përket përgjegjësisë penale gjykata ka vërtetuar se në shkresa të lëndës nuk ka prova lidhur me përjashtimin e përgjegjësisë penale ose se tek i njëjti ekziston aftësia esencialisht e zvogëluar, e në anën tjetër as i pandehuri nuk i ka ofruar gjykates ndonjë provë në këtë drejtim, andaj edhe nga gjendja faktike e vërtetuar i pandehuri me vet faktin se ka kuptuar rëndësinë e veprimit të tij kriminal duke pasur mundësi që t'i kontrolloj sjelljet e tij e të mos i fal besimin të tjerëve për të inkriminuar vetvetën, është vërtetuar se i njëjti është përgjigjes penalisht për veprën penale lëndore.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73, 74 dhe 75 të KPRK-s edhe atë si rrethana lehtësuese ka pasur

parasysh : pranimin e fajësisë pa hezitim duke shprehur keqardhje, pendimin e sinqert të të pandehurit, premtimin serioz se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, se më parë nuk ka qenë i gjykuar, se ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale, gjendjen ekonomike jo të tij dhe se është mbajtës i vetëm i familjes shumë anëtarëshe ndërsa si rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Kështu që gjykata duke pasur parasysh provat e bashkëngjitura aktit akuzues ashtu të paadministruara nga të cilat dalin faktet relevante ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me akuzën lëndore përkatësisht vepren penale, e duke i pasur parasysh rrethanat e lartcekura lehtësuese në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPRK-s duke u bindur se edhe me një dënim me kusht në kuptim të nenit 51 të KPRK-s, mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit në kuptim të nenit 50 lidhur me nenin 41 të KPRK-s, me bindje të plotë se mund të ndikohet në mënyrë rehabilituese dhe parandaluese si tek i pandehuri ashtu edhe tek qytetarët potencial, duke i disiplinuar të njëjtit lidhur me respektimin e të mirave juridike të mbrojtura me ligj penal të vendit.

Gjykata me rastin e shpalljes së aktgjykimit në kuptim të nenit 368 të KPP e ka njoftuar të pandehurin lidhur me rëndësinë e dënimit me kusht por edhe kushtet të cilave duhet t'iu përmbahet në mënyrë që dënimi me kusht mos të revokohet, por edhe duke e njoftuar me pasojat në rast se nuk i përmbahet udhëzimeve të dhëna.

Me rastin e shpalljes së aktgjykimit palët shprehimisht kanë deklaruar se heqin dorë nga e drejta në ankesë, andaj edhe kryetari i trupit gjykues konstaton se në kuptim të nenit 485 paragrafi 2 të KPP-s aktgjykimi lëndor është bërë i plotfuqishëm më datën 25 shkurt të vitit 2021.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor vendosi në kuptim të nenit 450 lidhur me nenin 453 të KPP ndërsa lidhur me kompensimin e viktimave të krimit në kuptim të nenit 39 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Ligji nr.05/L-036.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i krimeve të rënda  
PKR.nr. 13/2021 më dt. 25 shkurt të vitit 2021**

**Sekretarja juridike,**  
Kadrije Zymberi

**Kryetari i trupit gjykues,**  
Aziz Shaqiri

**Udhëzim për mjetin juridik:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i krimeve të rënda, në afat prej pesëmbëdhjetë ( 15 ) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj Gjykate.

**VËREJTJE:** në kuptim të nenit 485 paragrafi 2 të KPP-s ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm më datën 25 shkurt 2021, meqë palët shprehimisht kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë.

Numri i lëndës: 2021:002158  
Datë: 09.03.2021  
Numri i dokumentit: 01577991